**VENDIM**
**Nr. 65, datë 2.2.2022**

**PËR PLANIN VJETOR TË PRANIMIT PËR VITIN 2022 NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE, PJESË TË SHËRBIMIT CIVIL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i vendeve vakante të planifikuara për rekrutim gjatë vitit 2022 është gjithsej 850 (tetëqind e pesëdhjetë), të ndara sipas kategorive të mëposhtme:

a) Për trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues 53;
b) Për kategorinë e mesme drejtuese 3;
c) Për kategorinë e ulët drejtuese 190;
ç) Për kategorinë ekzekutive 604.

2. Grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm në kategorinë ekzekutive janë, si më poshtë vijon:

- Shkenca juridike;
- Audit i brendshëm;
- Shkenca ekonomike;
- Shkenca ekonomike/juridike;
- Shkenca shoqërore;
- Shkenca sociale;
- Histori-filologji;
- Shkenca mjekësore;
- Veterinari;
- Agronomi;
- Shkenca biologjike dhe të ngjashme me to;
- Kimi;
- Shkenca mjedisore ose të tjera të përshtatshme;
- Shkenca inxhinierike;
- Arkitekturë;
- Arkeologji dhe restaurime;
- Artet e bukura;
- Gjeodezi;
- Shkenca ekzakte;
- Shkenca edukimi;
- Mësuesi;
- Arsim i lartë ushtarak/policor;
- Arsim i lartë.

3. Institucionet e administratës shtetërore, ku planifikohen vendet vakante gjatë vitit 2022, janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Arben Ahmetaj**

**Lidhja nr. 1**

**Lista e institucioneve të administratës shtetërore ku planifikohen vendet vakante gjatë vitit 2022**

1. Kryeministria dhe institucionet në varësi të saj;
2. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
3. Sistemi i ministrisë së Brendshme;
4. Sistemi i ministrisë së Mbrojtjes;
5. Sistemi i ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
6. Sistemi i ministrisë së Drejtësisë;
7. Sistemi i ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
8. Sistemi i ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
9. Sistemi i ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
10. Sistemi i ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
11. Sistemi i ministrisë së Arsimit dhe Sportit;
12. Ministria e Kulturës.